



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

Dep. DPKPP  
 Nr. pages 02  
 Nr. Prot. 03-03/3645/16  
 Data Datum 11.10.2016  
 PRISH

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	11.10.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/3550/16
PËR/ZA/TO:	z. Bujar KUÇI , Shef i zyrës së Prokurimit në Komunën e Suharekës
CC:	z. Sali ASLLANAJ , Kryetar i Komunës së Suharekës,
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Ndërtimi i rrugës Naum Veqilharxhi në Sopijë - vazhdim"

*I nderuari z. Kuçi ,*

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin "Ndërtimi i rrugës Naum Veqilharxhi në Sopijë- vazhdim" me numër të prokurimit: 624-16-105-536, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Ndërtimi i rrugës Naum Veqilharxhi në Sopijë- vazhdim" me numër të prokurimit: 624-16-105-536, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

## *Arsy etimi*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia) me datë 06.10.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-03-3550/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Ndërtimi i rrugës Naum Veqilharxhi në Sopijë- vazhdim*" me numër të prokurimit: *624-16-105-536*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Suharekës. Agjencia, me datë 10.10.2016, ka paraqitur kërkesën për dokumentacion, ku ka kërkuar nga Autoriteti kontraktues t'a dorëzojë në Agjenci dokumentacionin përkatës për këtë aktivitet të prokurimit para hapjes së tenderëve.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit, konstaton se autoriteti kontraktues ka paraparë kontratë për punë ndërtimore me vlerë të vogël të cilën e ka zhvilluar në procedurë të kuotimit të çmimeve, veprim ky i cili bie ndesh me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik. Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka zgjedhur procedurën e duhur për realizimin e punëve për këtë projekt. Sipas nenit 36 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik paragrafi 1 dhe pika 1.1 thuhet decidivisht se "**Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për kuotimin e çmimeve për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punëve, furnizimeve ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël, në rast të kontratave për punë përfshinë vetëm riparime apo mirëmbajtje**". Sipas këtij Ligji nuk lejohet që me procedurën e kuotimit të çmimit të realizohen punë ndërtimore.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Veprimet e autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin, nenin 27 dosja e tenderit, si dhe nenin 36 Procedurat për kuotimin e çmimeve të Ligjit për prokurimin publik nr.04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

**Me respekt !**